



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të dispozitave të nenit 5 të Rregullores për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira, 01 nr. 215-361, të dt. 04.05.2006, takimeve të mbajtura më 03.10.2006 dhe më 09.10.2006, në mes të udhëheqësve të Komunës së Prishtinës dhe kryetarëve të Grupeve parlamentare, të cilët marrin pjesë në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, dhe miratimit në Komitetin për Politikë dhe Financa më 17.11.2006, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2006 mori

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BANESAVE SIPAS KATEGORIVE

- I. CAKTOHET, numri i banesave sipas kategorive me të drejtë përfitimi të banesës në shfrytëzim me qira, të cilat i ka Komuna.
- II. Numri i banesave, sipas kategorive të prēmendura nën I të këtij Vendimi është si në vijim:
 - a) Për të punësuarit në shërbimin civil të Komunës së Prishtinës parashihen 27 banesa, prej të cilave 6x2 dhomëshe, 3x3 dhomëshe, 16x4 dhomëshe dhe 2x5 dhomëshe;
 - b) Për kshilltarët e Kuvendit të Komunës parashihen 10 banesa, prej të cilave 1x2 dhomëshe, 5x3 dhomëshe, 4x4 dhomëshe;
 - c) Për rastet tjera parashihen 11 banesa, prej të cilave: 2x2 dhomëshe dhe 9x3 dhomëshe.
- III. Procedura e ndarjes së banesave të cekura nën 2 të këtij Vendimi, do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira 01. nr. 215-36, të dt. 04.05.2006.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.360-543/1, më 23.11.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri